



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:265564
Datë: 19.08.2022
Numri i dokumentit: 03343496

C.nr.1013/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarës Kaltrinë Haliti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.F nga ...te cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.M avokat nga Prishtina, e ushtruar kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve "E", me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit, në vlerë 11,030.00€, jashtë seancës gjyqësore, më datën 19.08.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit H.F e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit me objekt kontesti kompensimi i dëmit, në vlerë 11,030.00€

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi me dt.14.11.2019, kundër të paditurve me objekt kontesti kompensimi i dëmit, në vlerë 11,030.00€

Gjykata me datën 17.08.2022 ka pranuar parashtrëse nga përfaqësuesi i paditësit me të cilën ka njoftuar se me të paditurin, paditësi ka arritur ujudi jashtëgjyqësore, për kompensimin e dëmit, dhe ka deklaruar se janë tërhequr nga padia, për kompensimin e dëmit për të njëjtin, gjithashtu ka shtuar se për pagesën e ekspertizës për vlersimin dëmit, do t'ia bëjnë direkt ekspertit. Andaj në këtë fazë të procedurës e tërheqin padinë.

Gjykata në lidhje me këtë çështje të paditurës, nuk ja dergoi njoftimin siç e parasheh neni 261.2 i LPK-së, pasi që palet ndërgjyqëse kanë arritur ujudi jashtëgjyqësore, kurse nga gjendja e shpjeguar më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 261.3 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj, nga të lartëcekuarit e në pajtim me dispozitat e nenit 387.1 nën pika c) të ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

C.NR.1013/19 dt.19.08.2022

Gjyqtarja,
Kaltrinë HALITI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia, konform nenit 261.4 të LPK-së nuk është e lejuar ankesa.

Numri i lëndës: 2019:265564
Datë: 19.08.2022
Numri i dokumentit: 03343496